

Znj. Eva Bica ka lindur në Elbasan me 14 tetor 1984.

Ajo mban titullin “Master i Shkencave” në Juridik, marrë në Universitetin e Torinos. Në të njëjtin Universitet Znj. Bica ka kryer studimet në të Drejtën Administrative dhe Organizatat Ndërkombëtare në vitin 2006.

Prej vitin 2013 mban titullin Avokat, profesion të cilin e ka ushtruar në studion e saj ligjore.

Gjithashtu, znj. Bica ka ndjekur me sukses disa trajnime të lidhura me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

Znj. Bica është njohëse e mirë e politikave në fushën e arsimit dhe të legjislacionit të qeverisjes vendore. Për 3 vite ka mbajtur pozicionin e Drejtores së Kabinetit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Më parë ka mbajtur pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm në Prefekturën e Qarkut Elbasan, si dhe ka qenë pjesë e administratës së Bashkisë Elbasan si Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Projekteve, Aseteve dhe Prokurimeve.

Prej vitit 2019 znj. Bica është anëtare e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Elbasan.

Që prej tetorit 2023 mban postin e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Trajtimit të Pronave.